



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.202/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc.Muhamet Rexha, kryetar, Milena Gjeriq dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses A. R. nga F. K., të cilën e përfaqëson Avokati Xhavit Krasniqi nga P., kundër të paditurit Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim B. M., për shkak të kompensimit të dëmit mbi bazën e privimit pa të drejtë nga liria, përkitazi me revizionin e të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.798/20 datë 15.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.05.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht si i themeltë revizioni i të paditurit dhe ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.798/20 dt.15.02.2024 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3287/12 i dt.14.10.2019, vetëm në pjesën e I pika nën a. e dispozitivit të tij, që ka të bëjë me lartësinë e kompensimit të dëmit jo material për shkak të privimit pa të drejtë nga liria, ashtu që gjykohet : Detyrohet i padituri, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të privimit pa të drejtë nga liria, nga data 23. 08. 2004 deri më dt. 25. 08. 2004 (2 ditë), t'i paguajë shumën prej 120.00 euro.

II. Në pjesën tjetër, revizioni i të paditurit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, Ac.nr.798/20 dt.15.02.2024, refuzohet si i pa bazuar.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.798/20 datë 15.02.2024, refuzohen si të pathemelta ankesat e palës paditëse dhe e palës së paditur, vërtetohet aktgjykimi i GjykatësThemelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil C.nr.3287/12 dt.14.10.2019, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditëses dhe detyrohet i padituri (KGJK), që paditëses në emër të dëmit jo material për privim të

pa arsyeshëm dhe të pa drejtë nga liria, për kohën e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 2 ditësh, t'ia paguajë shumat e specifikuara si më poshtë: a. Për vuajtje psikike, fizike dhe shpirtërore si dhe frikë të përjetuar të të gjitha intensiteteve për dy ditë të qëndrimit në paraburgim, shumën prej 500-euro. b. Në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurën penale në emër të mbrojtjes nga avokati, shumën prej 2,555.28 euro. Me pjesën e II të dispozitivit të tij, detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shumat e cekura në dispozitivin I, me kamatë si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar nga dita e marrjes së aktgjykimit dt.14.10.2019 e deri në përmbushje definitive, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 1,131 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën detyrimin e përmbarimit të detyrueshëm. Me pjesën e III të dispozitivit të tij, refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumat e aprovuara, në shumë prej 19,530-euro, si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ka paraqitur revizionin i padituri për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, Gjykata Supreme e Kosovës ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, dhe çështjen kontestimore të ia kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të LPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të revizionit si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Revizionin i të paditurit është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më dt.17.12.2012, paditësja, kundër të paditurit, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për shkak të kompensimit të dëmit mbi bazën e privimit pa të drejtë nga liria, me kërkesën dhe të dhënat si në petitumin e padisë dhe precizimit të saj. Gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara ka gjetur se, midis palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është mbajtur në paraburgim për dy ditë, është privuar pa bazë nga liria prej dt. 23.08.2004 deri 25.08.2004. Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dt.7.09.2012, del se paditësja ishte akuzuar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës zyrtare” nga neni 339.3 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, dhe me këtë aktgjykim, më pas, ndaj saj, refuzohet aktakuza.

Pastaj, paditësja i është drejtuar me kërkesë të paditurit Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjegjësisht, Komisionit për kompensimin e dëmit personave të dënuar pa arsye dhe të privuar nga liria pa bazë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material. I padituri (KGJK), nëpërmjet Komisionit të sipër cekur dhe paditësja, kishin negociuar për lidhjen e ujdisë jashtëgjyqësore dhe asaj i është ofruar marrëveshje, ashtu që 18 euro në emër të kompensimit të dëmit material dhe 18

euro në emër të kompensimit të dëmit jo material. Mirëpo, nga provat shkresore, rrjedh se paditësja nuk e ka pranuar ofertën e ofruar, prandaj, iu ka drejtuar gjykatës me padi për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provën me ekspertizën e ekspertit nga lëmi i psikiatrisë dr.S. B., e cila ka paraqitur mendimin me shkrim si dhe shpjegimet shtesë në seancë gjyqësore, me konstatimet se paditësja gjatë qëndrimit në paraburgim, ka përjetuar mërzitje, frikë, ankth, për gjendjen e saj dhe të familjes së saj, e shqetësuar për fatin e saj, e zhgënjyer, ka pasur dhimbje shpirtërore dhe frikë të llojit dhe intensitetit të përshkruar në mënyrë detaje në ekspertizën e ekspertes së psikiatrisë e cila gjendet në shkresat e lëndës, përkatësisht, në procesverbal të seancës gjyqësore. Po ashtu, nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara, si procesverbalet e seancave gjyqësore, procesverbaleve të marrjes në pyetje të paditëses, konfirmimit të aktakuzës etj, përderisa, ndaj saj zhvillohej procedura penale, del se ajo është mbrojtur nga mbrojtësi i saj avokati i saj i angazhuar dhe se të njëjtës i janë shkaktuar shpenzimet përkatëse lidhur me mbrojtjen në këtë procedurë.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe në bazë të dispozitave të nenit 154, nenit 200 të LMD-së, nenit 323, nenit 452 të LPK-së, nenit 538 të KPPK-së, nenit 5, par. 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, etj, ka vendosur si në pjesën I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore i ka refuzuar si të pa themelta ankesat e palëve ndërgjyqëse dhe ka vërtetuar si të ligjshëm aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktgjykimet e sipër përmendura të gjykatave të instancës më të ulët, nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në kontekst dhe përkitazi me rastin konkret civil - juridik, kjo gjykatë, konsideron se përgjegjësia e të paditurit për të kompensuar dëmin paditëses, veç tjerash, rezulton dhe gjen mbështetje edhe në dispozitat e nenit 154 dhe nenit 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978). Sipas nenit 154 të LMD-së, përcaktohet se “Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij “. Ndërsa, me dispozitën e nenit 200.1 të LMD-së parashihet shprehimisht se “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet

e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, nëse gjen se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material “ , ndërsa, me par.2 të këtij neni përcaktohet se “ Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror “ .

Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët gjyqësore, përkitazi me ekzistimin e detyrimit ligjor të palës së paditur për kompensimin e dëmit, palës paditëse, mirëpo, e njëjta, vlerëson se, kur është fjala për miratimin e lartësisë së kompensimit të këtij dëmi, përkatësisht, lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses, nga gjykatat e instancës më të ulët, përkitazi me pjesën e I, pika nën a. e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material për privimin e pa arsyeshëm dhe pa të drejtë nga liria, për dy ditë, për frikë, dhimbje shpirtërore etj, gabimisht është zbatuar e drejta materiale.

Përcaktimi i kompensimit për dëmin jo material paraqet zbatim të së drejtës materiale, ndërsa, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, shumica e gjykuar, në emër të kompensimit të dëmit për shkak të privimit pa të drejtë nga liria të paditëses, në lartësi prej 500-euro, nga gjykatat e instancës më të ulët, nuk është adekuate dhe nuk është në përputhje me kriteret e parapara me dispozitat e nenit 200 të LMD-së, për të cilën arsye aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, në këtë pjesë janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndaj, kjo gjykatë, duke miratuar pjesërisht revizionin e të paditurit, u dashtë që të njëjtit t’i ndryshojë, ashtu që detyroi të paditurin, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të privimit pa të drejtë nga liria, për dy ditë, t’i paguajë shumën prej 120- euro.

Sa i përket kësaj shume, kjo gjykatë, vlerëson se e njëjta është në korrelacion me natyrën, peshën, llojin, shkallën e dëmit të pësuar dhe vlerave të dëmtuara të paditëses, intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës dhe dhimbjeve të specifikuar, sikundër që është edhe në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate, për rastet e ngjashme apo identike, dhe me standardin jetësor të qytetarëve në Republikën e Kosovës. Dhe kur jemi këtu, Gjykata, sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim.

Shuma e gjykuar në emër të kompensimit të sipër cekur, nuk ka qëllim fitimprurës ( lukrativ ), por, rivendosjen e ekuilibrit psikik të rrënuar tek paditësja, si një satisfakcion për të njëjtën.

Për sa i përket pretendimit të revizionit të palës së paditur, përkitazi me pjesën e I, pika nën b. të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka të bëjë me shpenzimet e krijuara gjatë procedurës penale ndaj paditëses, në emër të mbrojtjes nga avokati, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se i njëjti është i pa qëndrueshëm. Kështu, nga se nga provat e administruara nga gjykata e instancës më të ulët, rezulton se është provuar fakti që paditësja vërtetë ka pasur shpenzimet përkatëse gjatë zhvillimit të procedurës penale, në lartësinë e shumës si në pikën e sipër përmendur, gjë që, veç tjerash, argumentohet edhe nga shikimi i leximi i Tarifës (nr.tarifor nr.1 dhe 2) së Odës së Avokatëve të Kosovës, dt.29.10.2011, si dhe nga procesverbalet e nëntë seancave gjyqësore, me numër e datë, si në shkresat e lëndës, ndaj, nga këtu, kërkesa e saj ka rezultuar si e bazuar.

Nga arsyet e sipër përmendura, dhe në mbështetje të nenit 222 dhe nenit 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.202/2024 datë 20.05. 2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha